



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1728/4 prot.

Datë 27.07.2023

V E N D I M

Nr. 679/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.07.2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Mobility” SHPK & “Marketing&Distribution” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-72129-06-09-2023, me objekt: “*Furnizim me automjete me qira për CENS-in në Qark dhe Bashki*” me fond limit 29,843,333.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 27.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Instituti i Statistikave.

Ankimues: BOE “Mobility” SHPK & “Marketing&Distribution” SHPK
Rruga “Sulejman Delvina”, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Instituti i Statistikave
Rr. Vllazën Huta, Nd. 35, H.1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen*”

e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlëra limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 12.06.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-72129-06-09-2023, me objekt: “*Furnizim me automjete me qira për CENS-in në Qark dhe Bashki*” me fond limit 29,843,333.00 lekë pa TVSH.

II.2. Në datën 27.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Instituti i Statistikave ka zhvilluar procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.3. Në datën 12.07.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave si vijon:

BOE “Mobility” SHPK & “Marketing&Distribution” SHPK 28.880.000 lekë, skualifikuar

BOE “Mobility” SHPK & “Marketing&Distribution” SHPK është njoftuar për arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

Bashkimi i Operatoreve Ekonomike nuk permbush kriteret e meposhtme:

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose me kontratë qeraje ose me marreveshje/kontrate bashkepunimi (të vlefshme), servis të specializuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e llojit të mjetit të ofruar.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun teknik, në të cilin të jenë të markuara në mënyrë të qartë dhe të dallueshme pjesët/ fragmente që i përkasin të dhënave teknike të mjetit të ofruar në përputhje me specifikimet teknike. Pjesët e katalogut me të dhënat/ specifikimet teknike të kërkuara në DST sipas përcaktimeve në shtojcën 5 duhet të jenë të përkthyer në shqip dhe të noterizuara”.

II.4. Në datën 17.07.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e anulimit për procedurën e prokurimit në sistemin elektronik të prokurimeve.

II.5. Në datën 18.07.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1728/2023 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3280 e BOE “Mobility” SHPK & “Marketing&Distribution” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-72129-06-09-2023, me objekt: “*Furnizim me automjete me qira për CENS-in në Qark dhe Bashki*” me fond limit 29,843,333.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 27.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Instituti i Statistikave.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Mobility” SHPK & “Marketing&Distribution” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 1728/2 prot datë 19.07.2023, me arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Mobility” SHPK & “Marketing&Distribution” SHPK.

II.7. Në datën 25.07.2023 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1728/3 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr.1423 prot., datë 21.07.2023 me objekt: “*Përgjigje KPP-së në lidhje me ankesën nr.1728 prot., datë 19.07.2023*”, drejtuar KPP-së

dhe BOE ankimues. Referuar kësaj shkrese rezulton se KSHA e ka refuzuar ankesën e BOE “Mobility” SHPK & “Marketing&Distribution” SHPK.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të BOE “Mobility” SHPK & “Marketing&Distribution” SHPK se: *“Bashkimi i Operatoreve Ekonomike nuk permbush kriteret e meposhtme: 2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose me kontratë qeraje ose me marreveshje/kontrate bashkepunimi (të vlefshme), servis të specializuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e llojit të mjetit të ofruar”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7, “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.3. e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar si më poshtë vijon:

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose me kontratë qeraje ose me marreveshje/kontrate bashkepunimi (të vlefshme), servis të specializuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e llojit të mjetit të ofruar.

Argumentimi teknik:

Kjo kërkesë lidhet me detyrimin e operatorit ekonomik që gjatë gjithë shtrirjes të kontratës të jetë në gjendje të sigurojë suportin teknik të mjeteve sipas standartit teknik të përcaktuar nga prodhuesi.

Argumentimi ligjor:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 (pikën 1/c) dhe pikën 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

III.1.2. Në shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike” dhe Shtojcën 6 “Formulari I Sasisë dhe Grafikut të Lëvrimit”, pjesë e dokumentave të tenderit të publikuara në SPE, rezulton se është kërkuar si vijon:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të

paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

ANEKS

Automjete për Zyrat e Censit në Qark

Numri i automjeteve: 13 (trembëdhjetë)

Afati me qera: **12.07.2023 – 12.12.2023**

Përshkrimi: Automjetet duhet të jenë me kalueshmëri të lartë për të përballuar lëvizjen në fshatra e qendra të banuara ku ka mungesë të transportit për arsye të terreneve të vështira, në të gjithë territorin e Shqipërisë. Komode për udhëtimin e punonjësve dhe hapsirë të mjaftueshme në bagazh.

Autoveturë Tipi: SUV

Cilindra "cc": Max 2.0

Lënda Djegëse: Naftë/ Benzinë

Traksoni: 4x4

Viti i Prodhimit: jo më e vjetër se prodhim i vitit 2018

Numri i vendeve: 4+1

Numri i Dyerve: 5

Elementë të tjerë:

- Krik automjeti, xhiromakinë, kutia e ndihmës së shpejtë, etj.
- Automjeti duhet të jetë me doganë dhe çdo taksë tjetër të paguar për gjatë të gjithë afatit të qerasë.
- Automjeti duhet të jetë i pajisur me siguracion kasko për gjatë të gjithë afatit të qerasë.
- Automjeti duhet të ofrohet me shërbime të përfshira për periudhën e qerasë.
- Të ofrojë, në rast nevojë, zëvendësimin e automjetit brenda 48 orëve.
- Të ofrojë shërbim falas "GPS për real-time tracking" të aksesueshëm nga INSTAT për dokumentim dhe monitorim të lëvizjeve.

Automjete për Zyrat Censit në Bashki

Numri i automjeteve: 54 (pesëdhjetë e katër) të shpërndara në bashki sipas lisës bashkëlidhur.

Afati me qera: **28.08.2023 – 28.11.2023 (3 muaj)**

Përshkrimi: Automjetet duhet të jenë me kalueshmëri të lartë për të përballuar lëvizjen në fshatra e qendra të banuara ku ka mungesë të transportit për arsye të terreneve të vështira, në të gjithë territorin e Shqipërisë. Komode për udhëtimin e punonjësve dhe hapsirë të mjaftueshme në bagazh.

Cilindra "cc": Min 1.4

Lënda Djegëse: Naftë/ Benzinë

Numri i vendeve: 4+1

Viti i Prodhimit: jo më e vjetër se prodhim i vitit 2018

Numri i Dyerve: 4

Elementë të tjerë:

- Krik automjeti, xhiromakinë, kutia e ndihmës së shpejtë, etj.
- Automjeti duhet të jetë me doganë dhe çdo taksë tjetër të paguar për gjatë të gjithë afatit të qerasë.
- Automjeti duhet të jetë i pajisur me siguracion kasko për gjatë gjithë afatit të qerasë.
- Automjeti duhet të ofrohet me shërbime të përfshira për periudhën e qerasë.
- Të ofrojë, në rast nevoje, zëvendësimin e automjetit brenda 48 orëve.
- Të ofrojë shërbim falas "GPS për real-time tracking" në akses të INSTAT për dokumentim dhe monitorim.

MËNYRA E OPERIMIT:

1) Gjatë periudhes se kontraktimit detyrimi i vetëm i institucionit është furnizimi i mjeteve për kryerjen e aktiviteteve të tij dhe njoftimi i operatorit për çdo problematik të hasur.

2) Automjetet duhet të kenë kontroll teknik vjetore (kollaudim).

3) Ofertuesi duhet të ofrojë asistencë teknike 24h/7.

4) Të bëjë zëvendësimin e gomave në rast defekti.

5) Kryerjen e riparimeve rutinë (shërbime profilaktike).

6) Kryerjen e riparimeve jo-rutinë në rast nevoje.

7) Menaxhimin e aksidenteve dhe situatave që vijnë si pasojë e aksidenteve përfshirë: asistencën e menjëhershme rrugore, njerëzore, tërheqjen e makinës deri në pikën më të afërt të riparimit.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

NR. Qark	Nr. Bashki	Bashki	Nr. Automjete për periudhën 12.07.2023 – 12.12.2023 (5 muaj)	Nr. Automjete për periudhën 28.08.2023 – 28.11.2023 (3 muaj)
1	2	BERAT	1	1
	27	KUÇOVË		1
	44	POLIÇAN		1
	54	SKRAPAR		1
	58	URA VAJGURORE		1
2	3	BULOIZË		1
	7	DIBËR	1	1
	22	KLOS		1
	37	MAT		1
3	10	DURRËS	1	1
	26	KRUJË		1
	52	SHIJAK		
4	1	BELSH		
	4	CËRRIK		
	11	ELBASAN	1	1
	16	GRAMSH		1
	32	LIBRAZHD		1
	41	PEQIN		1
	45	PRRENJAS		1
5	8	DIVJAKË		
	12	FIER	1	1
	33	LUSHNJE		1
	36	MALLAKASTËR		1
	40	PATOS		
	48	ROSKOVEC		1
6	9	DROPULL		1
	15	GJIROKASTËR	1	1
	21	KËLCYRË		1
	31	LIBOHOVË		
	38	MEMALIAJ		1
	42	PËRMET		1
	55	TEPELENË		1
7	6	DEVOLL		1
	23	KOLONJË		1
	25	KORÇË	1	1
	35	MALIQ		1
	43	POGRADEC		1

	47	PUSTEC		
8	17	HAS		1
	28	KUKËS	1	1
	57	TROPOJË		1
9	29	KURBIN		1
	30	LEZHË	1	1
	39	MIRDITË		1
10	14	FUSHË ARRËS		1
	34	MALËSI E MADHE		1
	46	PUKË		1
	53	SHKODËR	1	1
	59	VAU I DEJËS		1
11	19	KAMËZ		
	20	KAVAJË		1
	49	RROGOZHINË		1
	56	TIRANË	2	3
	61	VORË		
12	5	DELVINË		1
	13	FINIQ		1
	18	HIMARË		1
	24	KONISPOL		1
	50	SARANDË		1
	51	SELENICË		1
	60	VLORË	1	1
		TOTAL	13	54

Afatet e ekzekutimit:

Artikulli	Përshkrimi	Sasia	Destinacioni	Data e dorëzimit
1	Automjete 4x4 (ne nivel Qarku)	13 copë	Instituti I Statistikave	5 (pese) muaj
2	Automjete (ne nivel Bashkie)	54 copë	Instituti i Statistikave	3 (tre) muaj

Afatet e lëvrimit: Afati kohor i ofrimit të mjeteve me qera, do të jetë për një periudhë kohore prej 5 (pese) muaj nga momenti i dorëzimit pranë AK për automjetet ne nivel Qarku (13 automjete) dhe 3 (tre) muaj nga momenti i dorëzimit për autombjete ne nivel bashki (54 automjete).

Lëvrimi: Mjetet duhet të dorëzohen brenda datës 12.07.2023 për Automjete 4x4 (ne nivel Qarku - 13 automjete) dhe ne date 18.08.2023 për Automjete (ne nivel Bashkie - 54 automjete).

III.1.3. Në ankesën e paraqitur nga ankimuesi pretendohet si vijon: “Në dokumentat Standarte të Tenderit parashikohet si më poshte vijon:

“2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose me kontratë qeraje ose me marrëveshje/kontrate bashkëpunimi (të vlefshme), servis të specializuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e llojit të mjetit të ofruar”

Në përmbushje të pikës së lartpërmendur BOE ka ngarkuar në sistemin elektronik të APP-së dokumentin “Mobility Shpk - Porsche Albania - Kontrate Servisi”, dokument i cili përmbush kriterin pasi në marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet palëve “Porsche Albania” dhe “Mobility” Shpk, në pikën A të faqës 1 ku sanksionon se: POAL (Porsche Albania) është tregtari i autorizuar i markave Volksäagen, Audi, Skoda dhe Seat në Shqipëri për mirëmbajtjen, servisimin dhe riparim e markave të mësipërme si dhe furnizimin me pjesë origjinale këmbimi dhe aksesore të këtyre markave.

Në këtë kontratë parashikohen në mënyrë të qartë detyrimet e te dyja paleve deri në detaje teknike si p.sh Periodiciteti i detyrueshem i shërbimeve që të mbajë garancinë, zbritjet për numrin e makinave, detaje të faturimit etj, fakte të cila vertetojnë që kontrata është e saktë dhe e vlefshme.

Gjithashtu ju bëjmë me dije se formati i paraqitur në tender në lidhje me dokumentin e mësipërm është formati i vetëm që Porsche Albania përdor, fakt i cili mund të vertetohet drejt për drejt dhe me një komunikim me ta.

Sqarojmë institucionin, se dokumenti i paraqitur, i lartpërmendur, e përmbush në mënyrë të plotë kriterin “2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose me kontratë qeraje ose me marrëveshje/kontrate bashkëpunimi (të vlefshme), servis të specializuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e llojit të mjetit të ofruar”, dhe si e tillë grupi i shqyrtimit të ankesës duhet të pranojë dokumentin e paraqitur.”

III.1.4. Lidhur me arsyen e skualifikimit, KSHA, në kthim përgjigjen e ankesës së paraqitur, argumenton si vijon:

“Lidhur me këtë pikë KVO është shprehur se nga dokumentacioni i ngarkuar në sistem nuk dëshmohet se BOE ka një marrëveshje/kontratë bashkëpunimi (të vlefshme), servis të specializuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e llojit të mjetit të ofruar.

Për të plotësuar kriterin 2.3.3, BOE ka paraqitur marrëveshjen ndërmjet dy subjekteve: nga njëra anë “Mobility” SHPK dhe “Select Services” SHPK dhe, nga ana tjetër, “Porsche Albania” SHPK [...]. Në pikën 11.1 të nenit 11 të kësaj marrëveshje, rezulton se hyrja në fuqi e saj është më datë 04.01.2023.

- Referuar ekstraktit historik të “Porsche Albania” SHPK, gjeneruar nga QKB, rezulton se administratorë të shoqërisë që nga prilli 2021 janë D. Eukoëitsch dhe G. Bushati, ndërsa në aktmarrëveshjen në emër të “Porsche Albania” SHPK është firmosur nga personi i autorizuar me prokurë Z.A.Gjoni. Prokura, si pjesë e marrëveshjes mungon.
- Në marrëveshje mungojnë Aneksat 1 dhe 2, të parashikuara përkatësisht në pikën 1.1 të nenit 1 dhe shkronjës B, fq.2 e marrëveshjes. Për këto arsye KSHA është e mendimit se nuk mund të vlerësohet nëse në aneks janë të përfshira automjetet që BOE ka ofruar për këtë shërbim, në plotësim të kërkesës “... servis të specializuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e llojit të mjetit të ofruara”.

- *Marrëveshja nuk është e plotë dhe nuk përmban elementëtë sigurisë mbi shprehjen e vullnetit formalisht për të marrë përsipër të drejta e detyrime ndërmjet dy personave juridikë, pasi nuk ka numër sekretimi të palëve përkatëse dhe nuk është nënshkruar në prani të noterit që të certifikojë autenticitetin e nënshkrimit. Faqet e marrëveshjes nuk janë të sigluara nga palët.*

Referuar sa më sipër, KSHA gjykon se mangësitë në këtë marrëveshje janë devijime thelbësore dhe ky kriter është i pa përmbushur.”

III.1.5. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.*

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme*

njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.6. Në procedurën e mësipërme të prokurimit, ka paraqitur ofertë vetën bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomikë “Mobility” SHPK & “Marketing&Distribution” SHPK. Në aktmarrëveshjen e lidhur ndërmjet dy shoqërive me datë 26.06.2023, në nenin 4 “Pjesëmarrja dhe përgjegjësitë”, ndër të tjera, është parashikuar se: “Mobility” SHPK – lider i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë merr përsipër të realizojë furnizimin me të gjitha llojet e ndryshme të automjeteve të kërkuara nga DST e procedurës së prokurimit public, objekt i kësaj kontrate.”

Nga shqyrtimi i ofertës së BOE ankimues konstatohet se është paraqitur formulari i ofertës, ku në përshkrimin e mallit rezulton se do të ofrohen 13 Skoda Kodiaq SUV 2.0 Naftë, Automatike vitet 2020-2023 dhe 54 Skoda Octavia 1.4 Benzinë, Automatike Viti 2022.

Për plotësimin e kërkesës së autoritetit kontraktor për servis të specializuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e llojit të mjetit të ofruar, sikurse është parashikuar në pikën 2.3.3. të kriterëve të vecanta të kualifikimit, si më sipër cituar, rezulton se është paraqitur një marrëveshje e lidhur në datën 23.06.2023 “Për shërbimin e mirëmbajtjes, riparimit dhe pjesëve të këmbimit dhe/ose aksesoret shoqërues,, ndërmjet kompanisë “PORSCHE Albania,, SHPK (POAL) dhe “Mobility” SHPK dhe “Select Services” meqënëse, citojmë:

- A. *POAL është tregtar i autorizuar i markave Volksäagen, Audi, Skoda dhe Seat në Shqipëri për mirëmbajtjen, servisimin dhe riparimin e markave të përmendura më sipër si dhe për furnizimin me pjesë origjinale këmbimi dhe aksesore të këtyre markave.*
- B. *Klienti ka në pronësi automjetet sipas listës bashkëngjiutr në Aneksin 2 me marka të përziera të grupit Volksvagen dhe kërkon të marrë shërbime të mirëmbajtjes dhe riparimit si dhe furnizime me pjesë këmbimi dhe pajisje për këto automjete nga POAL.*

C. POAL garanton se është i gatshëm t'i ofrojë klientit shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve në pronësi të tij, si dhe furnizimi i pjesëve të këmbimit sipas tremave të referencës dhe kushteve të përcaktuara më poshtë.

III.1.7. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik". Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

III.1.9. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, lidhur me pretendimet e KVO-së të bëra me dije ankimuesit nëpërmjet SPE-së se: *"Bashkimi i Operatoreve Ekonomike nuk përmbush kriteret e mëposhtme: 2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose me kontratë qeraje ose me marreveshje/kontrate bashkepunimi*

(të vlefshme), servis të specializuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e llojit të mjetit të ofruar”, KSHA është shprehur si vijon: “Lidhur me këtë pikë KVO është shprehur se nga dokumentacioni i ngarkuar në sistem nuk dëshmohet se BOE ka një marrëveshje/kontratë bashkëpunimi (të vlefshme), servis të specializuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e llojit të mjetit të ofruar. Për të plotësuar kriterin 2.3.3, BOE ka paraqitur marrëveshjen ndërmjet dy subjekteve: nga njëra anë “Mobility” SHPK dhe “Select Services” SHPK dhe, nga ana tjetër, “Porsche Albania” SHPK [...]. Në pikën 11.1 të nenit 11 të kësaj marrëveshje, rezulton se hyrja në fuqi e saj është më datë 04.01.2023.

- Referuar ekstraktit historik të “Porsche Albania” SHPK, gjeneruar nga QKB, rezulton se administratorë të shoqërisë që nga prilli 2021 janë D. Ēukoëitsch dhe G. Bushati, ndërsa në aktmarrëveshjen në emër të “Porsche Albania” SHPK është firmosur nga personi i autorizuar me prokurë Z.A.Gjoni. Prokura, si pjesë e marrëveshjes mungon.
- Në marrëveshje mungojnë Aneksat 1 dhe 2, të parashikuara përkatësisht në pikën 1.1 të nenit 1 dhe shkronjës B, fq.2 e marrëveshjes. Për këto arsye KSHA është e mendimit se nuk mund të vlerësohet nëse në aneks janë të përfshira automjetet që BOE ka ofruar për këtë shërbim, në plotësim të kërkesës “... servis të specializuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e llojit të mjetit të ofruara”.
- Marrëveshja nuk është e plotë dhe nuk përmban elementët e sigurisë mbi shprehjen e vullnetit formalisht për të marrë përsipër të drejta e detyrime ndërmjet dy personave juridikë, pasi nuk ka numër sekretimi të palëve përkatëse dhe nuk është nënshkruar në prani të noterit që të certifikojë autenticitetin e nënshkrimit. Faqet e marrëveshjes nuk janë të sigluara nga palët.”

Pra Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ka pranuar faktin se “BOE ka paraqitur marrëveshjen ndërmjet dy subjekteve: nga njëra anë “Mobility” SHPK dhe “Select Services” SHPK dhe, nga ana tjetër, “Porsche Albania” SHPK [...]”, por ka zgjeruar interpretimin e tij, duke dhënë arsye të reja skualifikimi për bashkimin e operatorëve ekonomikë ankimues, në tejkalim të kompetencave të tij, arsye skualifikimi për të cilat ankimuesi nuk ka dijeni.

III.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga LPP, janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në interpretim sistematik (domethënien e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), Komisioni i Prokurimit gjykon se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet procedural, atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë

të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor (rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor por nga një trupë e re, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me komisionin e vlerësimit të ofertave, shqyrtimin e ankesave nga K.Sh. A (Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave).

Normativa e parashikuar nga nenet 110 dhe 111 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimitimin për të vënë në lëvizje dhe investimin e autoritetit kontraktor për rishikimin e vendimit të KVO-së. Procedura përpara autoritetit kontraktor si edhe para KPP ka natyrën e procedurave të nxitura, pasi autoriteti kontraktor nuk mund të bëhet vetiniciatore e fillimit të procedurave kryesisht. Si rregull, investimi i K.Sh.A është i bazuar (faktikisht i kufizuar) nga ankimet e sjella pranë saj vetëm nga subjekte të legjitimuar.

Sa më sipër, KPP gjykon se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ka dalë jashtë tagreve dhe kompetencave të dhëna nga ligji dhe se KPP nuk mund të gjykojë mbi arsye për skualifikimin e ofertës ngritur nga autoriteti kontraktor në momentin e shqyrtimit administrativ të ankesës së dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues.

Komisioni gjykon se arsyet shtesë të parashtruara nga KSHA, janë në kundërshtim të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, ndaj këto arsye nuk sjellin asnjë pasojë mbi operatorin ekonomik ankimues e si të tilla nuk merren në shqyrtim nga KPP.

III.1.11. Gjithashtu konstatohet se, referuar arsyes së skualifikimit të cituar në raport audit nga komisioni i vlerësimit të ofertave sipas të cilit: “*Bashkimi i Operatoreve Ekonomike nuk përmbush kriteret e mëposhtme: 2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose me kontratë qeraje ose me marreveshje/kontrate bashkepunimi (të vlefshme), servis të specializuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e llojit të mjetit të ofruar*” rezulton se autoriteti kontraktor në rastin konkret, vlerësimin e ofertës së BOE ankimues dhe skualifikimin e tij, nuk e ka bërë në përputhje me vetë kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit, duke skualifikuar në mënyrë abuzive dhe të paargumentuar, pa përcaktuar se cilat janë mangësitë konkrete të konstatuara. Gjykojmë, se ashtu sikurse është barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, të vërtetojë se disponon kapacitetet tekniko-ligjore në lidhje me përmbushjen e kriterit konkret, si dhe të specifikimeve teknike të kërkuara, edhe autoriteti kontraktor (komisioni vlerësimit të ofertave) ka barrën e provës të vërtetojë dhe argumentojë, mangësitë e konstatuara. Bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, barra e provës në rastin konkret për vërtetueshmërinë e pretendimit (arsyes së skualifikimit), i takonte komisionit të vlerësimit të ofertave të identifikonte në mënyrë të saktë dhe të qartë, parregullsinë e konstatuar, duke dhënë argumentet mbi këtë fakt, i cili në rastin konkret ka dështuar t’i evidentojë dhe t’i argumentojë. Është detyrë e zyrtarëve përgjegjës, anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të pasqyrojnë në SPE vlerësimin e tyre, në mënyrë të qartë, konkrete dhe të kuptueshme. Referuar edhe jurisprudencës së Gjykatës Europiane të Drejtësisë, (shiko Çështjen C-27/15 Pippo Pizzo) ka konkluduar, se shkaqet e skualifikimit duhet të përcaktohen qartësisht dhe të publikohen paraprakisht në kohë të mjaftueshme, me qëllim që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të njihen me këto shkaqe. GJED në vendimin e

mësipërm ka konfirmuar, se “përcaktim qartësisht” i shkaqeve të skualifikimit, do të thotë që të garantohet se ofertuesit janë njohur me kërkesat specifike procedurale dhe që të njëjtat kërkesa, aplikohen njëjloj për të gjithë ofertuesit.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se shkeljet e mësipërme, cenojnë në thelb jo vetëm garancitë procedurale të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, por njëherazi cenojnë edhe parimin e sigurisë juridike. Në jurisprudencën e saj Inter Allia, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr. 12/2014 datë 17.03.2014 është shprehur se “*Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin*”. Sa më sipër, KPP gjykon, se në rastin konkret parimi i sigurisë juridike në kuptimin material të tij, konsiderohet edhe moscenimi i të drejtave të fituara dhe i pritshmërive të ligjshme që garantojnë aktet në fuqi.

III.2. Lidhur me arsyen e skualifikimit të ankimuesit se: “*Bashkimi i Operatoreve Ekonomike nuk përmbush kriteret e mëposhtme: 2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun teknik, në të cilin të jenë të markuara në mënyrë të qartë dhe të dallueshme pjesët/fragmente që i përkasin të dhënave teknike të mjetit të ofruar në përputhje me specifikimet teknike. Pjesët e katalogut me të dhënat/ specifikimet teknike të kërkuara në DST sipas përcaktimeve në shtojcën 5 duhet të jenë të përkthyer në shqip dhe të noterizuara*”, KPP vëren se:

III.2.1. Në shtojcën nr. 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë:

Automjete për Zyrat e Censit në Oark

Numri i automjeteve: 13 (trembëdhjetë)

Afati me qera: **12.07.2023 – 12.12.2023**

Përshkrimi: Automjetet duhet të jenë me kalueshmëri të lartë për të përballuar lëvizjen në fshatra e qendra të banuara ku ka mungesë të transportit për arsye të terreneve të vështira, në të gjithë territorin e Shqipërisë. Komode për udhëtimin e punonjësve dhe hapsirë të mjaftueshme në bagazh.

Autoveturë Tipi: SUV

Cilindra “cc”: Max 2.0

Lënda Djegëse: Naftë/ Benzinë

Traksoni: 4x4

Viti i Prodhimit: jo më e vjetër se prodhim i vitit 2018

Numri i vendeve: 4+1

Numri i Dyerve: 5

Elementë të tjerë:

- Krik automjeti, xhiromakinë, kutia e ndihmës së shpejtë, etj.
- Automjeti duhet të jetë me doganë dhe çdo taksë tjetër të paguar për gjatë të gjithë afatit të qerasë.
- Automjeti duhet të jetë i pajisur me siguracion kasko për gjatë gjithë afatit të qerasë.
- Automjeti duhet të ofrohet me shërbime të përfshira për periudhën e qerasë.
- Të ofrojë, në rast nevoje, zëvendësimin e automjetit brenda 48 orëve.
- Të ofrojë shërbim falas “GPS për real-time tracking” të aksesueshëm nga INSTAT për dokumentim dhe monitorim të lëvizjeve.

Automjete për Zyrat Censit në Bashki

Numri i automjeteve: 54 (pesëdhjetë e katër) të shpërndara në bashki sipas lisës bashkëlidhur.

Afati me qera: **28.08.2023 – 28.11.2023 (3 muaj)**

Përshkrimi: Automjetet duhet të jenë me kalueshmëri të lartë për të përballuar lëvizjen në fshatra e qendra të banuara ku ka mungesë të transportit për arsye të terreneve të vështira, në të gjithë territorin e Shqipërisë. Komode për udhëtimin e punonjësve dhe hapsirë të mjaftueshme në bagazh.

Cilindra “cc”: Min 1.4

Lënda Djegëse: Naftë/ Benzinë

Numri i vendeve: 4+1

Viti i Prodhimit: jo më e vjetër se prodhim i vitit 2018

Numri i Dyerve: 4

Elementë të tjerë:

- Krik automjeti, xhiromakinë, kutia e ndihmës së shpejtë, etj.
- Automjeti duhet të jetë me doganë dhe çdo taksë tjetër të paguar për gjatë të gjithë afatit të qerasë.
- Automjeti duhet të jetë i pajisur me siguracion kasko për gjatë gjithë afatit të qerasë.
- Automjeti duhet të ofrohet me shërbime të përfshira për periudhën e qerasë.

- Të ofrojë, në rast nevoje, zëvendësimin e automjetit brenda 48 orëve.
- Të ofrojë shërbim falas “GPS për real-time tracking” në akses të INSTAT për dokumentim dhe monitorim.

MËNYRA E OPERIMIT:

- 1) Gjatë periudhes se kontraktimit detyrimi i vetëm i institucionit është furnizimi i mjeteve për kryerjen e aktiviteteve të tij dhe njoftimi i operatorit për çdo problematik të hasur.
- 2) Automjetet duhet të kenë kontroll teknik vjetore (kolaudim).
- 3) Ofertuesi duhet të ofrojë asistencë teknike 24h/7.
- 4) Të bëjë zëvendësimin e gomave në rast defekti.
- 5) Kryerjen e riparimeve rutinë (shërbime profilaktike).
- 6) Kryerjen e riparimeve jo-rutinë në rast nevoje.
- 7) Menaxhimin e aksidenteve dhe situatave që vijnë si pasojë e aksidenteve përfshirë: asistencën e menjëhershme rrugore, njerëzore, tërheqjen e makinës deri në pikën më të afërt të riparimit.

III.2.2. Në shtojcën nr. 7 “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.4. të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë:

“2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun teknik, në të cilin të jenë të markuara në mënyrë të qartë dhe të dallueshme pjesët/ fragmente që i përkasin të dhënave teknike të mjetit të ofruar në përputhje me specifikimet teknike. Pjesët e katalogut me të dhënat/ specifikimet teknike të kërkuara në DST sipas përcaktimeve në shtojcën 5 duhet të jenë të përkthyer në shqip dhe të noterizuara.”

III.2.3. Në ankesën e paraqitur nga ankimuesi pretendohet si vijon: *“Në dokumentet standarte të tenderit është kërkuar: “2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun teknik, në të cilin të jenë të markuara në mënyrë të qartë dhe të dallueshme pjesët/ fragmente që i përkasin të dhënave teknike të mjetit të ofruar në përputhje me specifikimet teknike. Pjesët e katalogut me të dhënat/ specifikimet teknike të kërkuara në DST sipas përcaktimeve në shtojcën 5 duhet të jenë të përkthyer në shqip dhe të noterizuara”.*

Në lidhje me pikën e mësipërme kompania jonë ka ngarkuar në sistemin elektronik të APP-së dokumentin

“Katalog - Skoda Kodiaq i plote Anglisht”,

“Katalog - Skoda Octavia i plote Anglisht” dhe

“Katalogje makinash - perkthyer dhe noterizuar faqet qe duhen”.

Për dokumentet e mësipërme sqarojmë grupin e shqyrtimit të ankesës si më poshtë:

Në dokumentat e hedhura në sistemin elektronik të APP-së, janë hedhur katalogjet zyrtare në gjuhën angleze nga Porsche Albania (të dërguara prej tyre me email drejt Mobility Shpk me datë përpara organizimit të tenderit) ku nga këto katalogje janë përkthyer dhe noterizuar vetëm faqet që ishin të nevojshme për përmbushjen e specifikimeve teknike siç është kërkuar nga AK.

Në katalogun për modelin Skoda Octavia, duke qënë se ky është një katalog zyrtar i dërguar nga Porsche Albania dhe i vënë në dispozicion nga ana e tyre kompanisë tonë, katalogje që janë standarte dhe të cilat nuk mund të modifikohen apo përshtaten kërkesave për procedura të ndryshme pasi kemi të bëjmë me katalogje të cilat dalin nga prodhuesi në nivel botëror për mallin që prodhon. ”

III.2.4. Lidhur me arsyen e skualifikimit, KSHA, në kthim përgjigjen e ankesës së paraqitur, argumenton si vijon: “[...] Lidhur me këtë pikë KVO është shprehur se katalogët “Skoda_Kodiaq_i_plotë_Anglisht” dhe “Skoda_Octavia_i_plotë_Anglisht” janë të papërkthyer dhe të panoterizuara. Gjithashtu në to nuk janë markuar dukshëm fragmentet që i përkasin të dhënave teknike të mjetit të ofruar në përputhje me specifikimet teknike. [...] KSHA vëren se: Për të plotësuar kriterin 2.3.4 BOE ka paraqitur katalogë të tre tipe automjesh të markës Skoda. Ndërkohë që në Formularine Ofertës ka ofertuar vetëm për dy prej markave si më poshtë:

1	2	3	4
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	Njesia (Mua)
1.	Skoda Kodiaq SUV 2.0 Naftë, Automatike Vitet 2020-2023	13	5
2.	Skoda Octavia 1.4 Benzine, Automatike Viti 2022	54	3

- Për automjetin Skoda Kodiak 2.0 me naftë, e cila gjendet në katalog, është paraqitur katalogu i cili sipas shënimit në kopertinë, rezulton të ketë hyrë në fuqi më datë 01.06.2023, ndërsa oferta i referohet prodhimeve të viteve 2020-2023, pra automjetet e ofruara përputhen pjesërisht me ato të paraqitura në katalog.

- Për automjetin Skoda Octavia 1.4 me benzinë, e cila nuk gjendet në katalog (për këtë tip Skode me benzinë gjenden ato të fuqisë 1.0; 1.5; dhe 2.0), është paraqitur katalogu i cili sipas shënimit në kopertinë rezulton të ketë hyrë në fuqi me datë 01.06.2023, ndërsa oferta i referohet vitit 2022, pra katalogu nuk përputhet me të dhënat e ofertës.

- Automjetet e kërkuar në zërin nr.2 sipas specifikimeve teknike i plotësojnë parametrat e kërkuara “cilindri “cc”: Min 1.4 dhe lënda djegëse: Naftë/Benzinë”, por informacionet e dhëna në seksionet e ndryshme të dokumentave të tenderit duhet të përputheshin ndërmjet tyre dhe të mos krijonin konfuzion dhe hapësirë për interpretime.”

III.2.5. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.6. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve

teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor”

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Referuar dokumentacionit të administruar, Komisioni vëren se, për hartimin e specifikimeve teknike për produktet objekt-prokurimi, autoriteti kontraktor është bazuar në shkronjën “a”, të pikës 3, të nenit 36 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, duke vlerësuar si të domosdoshme dhe të rëndësishme kapacitetet funksionale të produkteve dhe performancën e tyre.

III.2.8. Komisioni Prokurimit Publik referuar arsyes së skualifikimit të cituar në raport audit nga komisioni i vlerësimit të ofertave se: “*Bashkimi i Operatoreve Ekonomike nuk përmbush kriteret e mëposhtme: 2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun teknik, në të cilin të jenë të markuara në mënyrë të qartë dhe të dallueshme pjesët/fragmente që i*

përkasin të dhënave teknike të mjetit të ofruar në përputhje me specifikimet teknike. Pjesët e katalogut me të dhënat/ specifikimet teknike të kërkuara në DST sipas përcaktimeve në shtojcën 5 duhet të jenë të përkthyer në shqip dhe të noterizuara”, konstaton se autoriteti kontraktor në rastin konkret, vlerësimin e ofertës së BOE ankimues dhe skualifikimin e tij, nuk e ka bërë në përputhje me vetë kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit, duke skualifikuar në mënyrë abuzive dhe të paargumentuar, pa përcaktuar se cilat janë mangësitë konkrete të konstatuara. Gjykojmë, se ashtu sikurse është barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, të vërtetojë se disponon kapacitetet tekniko-ligjore në lidhje me përmbushjen e kriterit konkret, si dhe të specifikimeve teknike të kërkuara, edhe autoriteti kontraktor (komisioni vlerësimit të ofertave) ka barrën e provës të vërtetojë dhe argumentojë, mangësitë e konstatuara. Bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës në rastin konkret për vërtetueshmërinë e pretendimit (arsyes së skualifikimit), i takonte komisionit të vlerësimit të ofertave të identifikonte në mënyrë të saktë dhe të qartë, parregullsinë e konstatuar, duke dhënë argumentet mbi këtë fakt, i cili në rastin konkret ka dështuar t’i evidentojë dhe t’i argumentojë. Është detyrë e zyrtarëve përgjegjës, anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të pasqyrojnë në SPE vlerësimin e tyre, në mënyrë të qartë, konkrete dhe të kuptueshme. Referuar edhe jurisprudencës së Gjykatës Europiane të Drejtësisë, (shiko Çështjen C-27/15 Pippo Pizzo) ka konkluduar, se shkaqet e skualifikimit duhet të përcaktohen qartësisht dhe të publikohen paraprakisht në kohë të mjaftueshme, me qëllim që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të njihen me këto shkaqe. GJED në vendimin e mësipërm ka konfirmuar, se “përcaktim qartësisht” i shkaqeve të skualifikimit, do të thotë që të garantohet se ofertuesit janë njohur me kërkesat specifike procedurale dhe që të njëjtat kërkesa, aplikohen njëjloj për të gjithë ofertuesit.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se shkeljet e mësipërme, cenojnë në thelb jo vetëm garancitë procedurale të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, por njëherazi cenojnë edhe parimin e sigurisë juridike. Në jurisprudencën e saj Inter Allia, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr. 12/2014 datë 17.03.2014 është shprehur se “*Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin*”.

Sa më sipër, KPP gjykon, se në rastin konkret parimi i sigurisë juridike në kuptimin material të tij, konsiderohet edhe moscenimi i të drejtave të fituara dhe i pritshmërive të ligjshme që garantojnë aktet në fuqi.

III.2.9. Gjithashtu rezulton se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, në përgjigjen e dhënë ankimuesit, është shprehur se: *“Për të plotësuar kriterin 2.3.4 BOE ka paraqitur katalogë të tre tipe automjetesh të markës Skoda. [...] - Për automjetin Skoda Kodiak 2.0 me naftë, e cila gjendet në katalog, është paraqitur katalogu i cili sipas shënimit në kopertinë, rezulton të ketë hyrë në fuqi më datë 01.06.2023, ndërsa oferta i referohet prodhimeve të viteve 2020-2023, pra automjetet e ofruara përputhen pjesërisht me ato të paraqitura në katalog. - Për automjetin Skoda Octavia 1.4 me benzinë, e cila nuk gjendet në katalog (për këtë tip Skode me benzinë gjenden ato të fuqisë 1.0; 1.5; dhe 2.0), është paraqitur katalogu i cili sipas shënimit në kopertinë rezulton të ketë hyrë në fuqi me datë 01.06.2023, ndërsa oferta i referohet vitit 2022, pra katalogu nuk përputhet me të dhënat e ofertës. - Automjetet e kërkuar në zërin nr.2 sipas specifikimeve teknike i plotësojnë parametrat e kërkuara “cilindri “cc”: Min 1.4 dhe lënda djegëse: Naftë/Benzinë”, por informacionet e dhëna në seksionet e ndryshme të dokumentave të tenderit duhet të përputheshin ndërmjet tyre dhe të mos krijonin konfuzion dhe hapësirë për interpretime”, duke dhënë arsye shtesë skualifikimi, të panjohura nga subjekti ankimues, në tejkalim të kompetencave të KSHA-së.*

III.2.10. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga LPP, janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në interpretim sistematik (domethënien e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), Komisioni i Prokurimit gjykon se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet procedural, atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor (rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor por nga një trupë e re, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me komisionin e vlerësimit të ofertave, shqyrtimin e ankesave nga K.Sh. A (Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave).

Normativa e parashikuar nga nenet 110 dhe 111 të ligjit nr.162/2020 *“Për Prokurimin Publik”* rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimimin për të vënë në lëvizje dhe investimin e autoritetit kontraktor për rishikimin e vendimit të KVO-së.

Sa më sipër, KPP gjykon se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ka dalë jashtë tagreve dhe kompetencave të dhëna nga ligji dhe se KPP nuk mund të gjykojë mbi arsye për skualifikimin e ofertës ngritur nga autoriteti kontraktor në momentin e shqyrtimit administrativ të ankesës së dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues.

Komisioni gjykon se arsyet shtesë të parashtruara nga KSHA, janë në kundërshtim të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, ndaj këto arsye nuk sjellin asnjë pasojë mbi operatorin ekonomik ankimues e si të tilla nuk merren në shqyrtim nga KPP.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Mobility” SHPK & “Marketing&Distribution” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-72129-06-09-2023, me objekt: “Furnizim me automjete me qira për CENS-in në Qark dhe Bashki” me fond limit 29,843,333.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 27.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Instituti i Statistikave.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e BOE “Mobility” SHPK & “Marketing&Distribution” SHPK, duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Mobility” SHPK & “Marketing&Distribution” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri

